VENDIM
Nr. 118, datë 10.6.2024

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "SMART TRADE & CONSULTING" SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5, germa "dh", 7, paragrafi 2 dhe 9, germa "d", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 5.1, germa "dh", të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/4 prot., datë 7.6.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SMART Trade & Consulting' sh.p.k. për heqjen e licencës",

konstatoi se:

- Shoqëria "SMART Trade & Consulting" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 389, seria T17/T22, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, rinovuar me vendimin nr. 235, datë 22.9.2022, për një afat 5-vjeçar (deri më 27.10.2027).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 965/2 prot., datë 3.5.2024, është paraqitur në ERE shkresa e nënshkruar nga administratori i shoqërisë "SMART Trade & Consulting" sh.p.k., vulosur me vulën e shoqërisë së licencuar, ku kërkohet heqja e kësaj licence.

- Shoqëria "SMART Trade & Consulting" sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në nenin 42, pika 1, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; në nenin 5, germa "dh", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017; në pikën 5.1, germa "dh", të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, përcaktohet se ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.

- Në nenin 7, paragrafi 2, të rregullores së sipërcituar përcaktohet se: "Në rast se i licencuari është propozuar për t'iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat "dh" dhe/ose "e", të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa "d", të kësaj rregulloreje, parashikohet se: ..... Bordi do të vendosë për të hequr licencën, subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "dh" dhe/ose "e", të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje.".

- Duke qenë se ndodhemi në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të procedohet menjëherë me miratimin e kësaj kërkese dhe heqjen e licencës. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kjo licencë e humbet fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "SMART Trade & Consulting" sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 389, seria T17/T22, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, rinovuar me vendimin nr. 235, datë 22.9.2022.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "SMART Trade & Consulting" sh.p.k., shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti